



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:142568
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05644350

KPPP.nr.2035/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Termoluli” Sh.p.k me NUI 810196536, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat Urim Bajraktari me seli në Ferizaj, kundër debitorit “Via” Sh.p.k me NUI 810835994, me seli në fshati Gërlic, Komuna Ferizaj, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.179/22 të datës 21.06.2022, të Përmbartuesit Privat Sheremet H. Livoreka me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Via” Sh.p.k i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.179/22 të datës 21.06.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Sheremet H. Livoreka.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.179/22 të datës 21.06.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Sheremet H. Livoreka.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Termoluli” Sh.p.k, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.179/22 të datës 21.06.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës numër 3277 e datës 21.12.2020, në

shumë prej 1.227,07 euro, numër 3345e datës 23.12.2020 në shumë prej 2,527.07 euro, numër prej 3381 e datës 25.12. 2020 në shumë prej 294.22 euro, numër 3407 e datës 26.12.2020 në shumë prej 127.00 euro, numër prej 3402 e datës 26.12.2020 në shumë prej 496.28 euro, me të cilat e ka urdhëruar debitorin, që t'ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekur shumën prej 3,444.57 €, me kamatë ligjore prej 8%, dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se asnjëherë nuk i ka ikur obligimit që ka ndaj kreditorit, por për shkak se një subjekt ka obligim ndaj këtu debitorit atëherë e ka sjellë edhe këtu debitorin në pozitë ndaj kreditorit termoluli, në një pozitë të vështirë nuk mos pasur mundësi të përmbushë obligimet dhe pagesat me kohë, për më tej ka deklaruar se qëllimi nuk është i ikjes së obligimit por janë në pritje të përfundimit të një procedurë tjetër përbarimore me qëllim të sigurimit të mjeteve dhe përfundimit të obligimit ndaj këtu kreditorit, në fund i ka propozuar gjykatës që të priset vendimi përbarimor.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, i ka kundërshtuar pretendimet si të pa bazuara, ndër të tjerash ka theksuar se pretendimet e debitorit lidhur me mos përmbushjen e obligimit ndaj kreditorit nuk kanë bazë ligjore, pasi që dokumentet përbarimore nuk janë kontestuar të njëjtat janë nënshkruar dhe pranua nga ana e debitorit, pos tjerash i ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi, ka kërkuar shpenzimet e përpilimit të përgjigjes në prapësim në shumë prej 208 euro

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit të përgjigjes në prapësim dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Faturat numër 3277 e datës 21.12.2020, në shumë prej 1.227,07 euro, numër 3345e datës 23.12.2020 në shumë prej 2,527.07 euro, numër prej 3381 e datës 25.12. 2020 në shumë prej 294.22 euro, numër 3407 e datës 26.12.2020 në shumë prej 127.00 euro, numër prej 3402 e datës 26.12.2020 në shumë prej 496.28 euro, në bazë të cilës është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i

përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe është i përshtatshëm për përmbardim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm respektivisht fatura e lartcekura i përmbard të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në rastin konkret rezulton se faturat janë dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila e cila vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit, andaj vërtetohet se debitori e ka pranuar faturën dhe të njëjtën nuk e ka kundërshtuar asnjëherë.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera te debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbardimore.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbardimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të debitorit për procedurën përmbardimore dhe atë në shumën prej 104.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifatat e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, Gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se urdhri për përmbartim i lejuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 29 të LPP-së, ngase nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2035/22, datë 30.04.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.